



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

RREGULLORE PËR TARIFAT, NGARKESAT DHE GJOBAT KOMUNALE (Teksti i spastruar)

Klinë, dhjetor 2014

Në bazë të dispozitës së nenit 12 pika 12.2 nenë c), e lidhur me nenin 40 pika 40.2 nenë (g.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 të publikuar në Fletorën zyrtare të Kosovës nr. 28, nenit 2 dhe 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, të publikuar në Fletorën zyrtare të Kosovës nr. 27 të dt.03.06.2008, nenit 10 paragrafi 2 pika 3 të Statutit të Komunës së Klinës i miratuar më dt.07.04.2010, pastaj duke pasur parasysh edhe të gjitha Udhëzimet përkatëse të nivelit qendror dhe ministror të lëmenjve përkatës lidhur me ngarkesat, tarifatat dhe taksat komunale, pas përfilljës se procedurës se rregullt të diskutimit publik Takimit publik të dt. 26.06.2014 si dhe leximit të parë më dt. 27.06.2014 dhe atij të dytë më dt. 29.08.2014, e tani duke iu referue edhe Shkresës se MAPL-ës nr. 02/04-1241/7 të dt.03.12.2014 si dhe rekomandimeve të Komisionit ndërministror të MF-ve dhe MAPL-ës të dt. 24.11.2014 lidhur më vlerësimin e ligjshmerisë, **Kuvendi i Komunës së Klinës** në seancën e vetë të rregullt të **XI-ën** më radhë për vitin 2014, të mbajtur më dt. **26.12.2014** kishte miratuar tekstin e spastruar të rregullorës lëndore ndërkaq qe në seancën e vetë të I-rë më radhë për vitin 2015 të mbajtur më dt. 30.01.2015 mbi bazën e përmirsimave të kërkuara nga Komisioni i përbashket i MF dhe MAPL-ës të dalura nga shkresa e dt.20.01.2015 miratohet vendim e veqantë për përmirsimin e gabimeve teknike ashtu qe kuvendi në tërsi,

m i r a t o i:

R R E G U L L O R E

Për

TARIFAT, NGARKESAT DHE GJOBAT KOMUNALE

(Teksti i spastruar)

PJESA HYRËSE

KAPITULLI I I-rë : DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi dhe përkufizimet

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen ngarkesat, tarifatat, taksat dhe gjobat tjera që Komuna mund t'i aplikoj për kryerjen e shërbimeve administrative komunale profesionale të caktuara për qytetarët, personat juridik dhe fizikë, në territorin e Komunës se Klinës.

Përkufizimet e nocioneve juridike dhe ligjore që dalin nga kjo rregullore (në tekstin e më tjem Rregullorja për Tarifatat, Ngarkesat dhe Gjobat komunale), më për së afërmi janë të përshkruara në nenin 1 të Ligjit për Financat Lokale 03/L-049, pastaj në nenin 1 në Ligjin bazë për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, po edhe ndryshimet e tija të më vonëshme, si dhe në Udhëzimet tjera përkatëse të Qeverisë së Kosovës, që ndërliiden me ngarkesat, tarifatat dhe taksat komunale.

Neni 2

Me shërbime sipas al.1 të nenit 1 të kësaj rregulloreje nënkuptohen: shërbimet profesionale dhe të tjera administrative komunale të kryera nga Administrata komunale e Komunës që ndërliiden me shërbimet komunale, lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare, më ngarkesat për ushtrimin e veprimtarive afariste, ushtrimin e punëve profesionale, ngarkesat për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, ngarkesat tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore, ngarkesat nga lëmi i urbanizmit, inspeksionit, gjobave përkatëse si dhe të gjitha ngarkesat dhe taksat tjera tarifore të lejuara më ligj.

Neni 3

Pagesa për shërbimet që i kryen komuna për qytetarët si dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë janë vendosur në pajtim me parimet e mbulimit të koston se shpenzimeve, të cilat reflektojnë shpenzimet e fuqisë punëtore, kohën e punës, shpenzimet e materialeve dhe pajisjeve të përdorura për të siguruar kryerjen e rregullt dhe efikase të shërbimeve administrative.

Pagesa për kryerjen e shërbimeve administrative komunale, bëhet në valutë e cila është e aplikueshme si mjet pagese në Kosovë.

Neni 4

Burimet e të hyrave vetjake komunale në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet përkatëse janë:

1. Tatimi në Pronën e paluajjtshme,
2. Ngarkesat për Shërbimet komunale,
3. Tarifat për Shërbimet e administratës komunale,
4. Gjobat në trafik dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale, dhe
5. Të hyrat tjera të lejuara më ligj.

Ngarkesat, tarifat dhe taksat me këtë rregullore do të caktohen sipas lëmive përkatëse dhe strukturës organizative administrative, duke përfshirë numrin rendor tarifor, përshkrimin si dhe vlerën e ngarkesës apo tarifës përkatëse.

Pagesa e ngarkesës, tarifës dhe taksës komunale

Neni 5

Të gjitha ngarkesat, tarifat apo taksat komunale, me rastin e kryerjes së shërbimeve komunale administrative duhet të paguhet me rastin e paraqitjes së kërkesës në komunë, për kryerjen e ndonjë shërbimi administrativ, për nxjerrjen e ndonjë certifikate, dokumenti tjetër administrativ, apo edhe kryerjen e ndonjë shërbimi tjetër profesional, kryerjen e ndonjë veprimtarie, por edhe shfrytëzimin e pronës komunale nga qytetari apo personi tjetër fizik dhe juridik.

Limitet e pagesës së drejtë për drejtë të ngarkesës, tarifës apo taksës dhe pagesave tjera në arkën komunale, si dhe limiti i pagesës përmes bankës përcaktohet me ligjin përkatës.

Lidhur me pagesën e tillë organi kompetent komunal, në pajtim më ligjin, lëshon dëftesën apo dokumentin tjetër si dëshmi përkatëse të pagesës.

Lirimi nga pagesa e ngarkesës, tarifës dhe taksës komunale

Neni 6

Nga pagesa e ngarkesës, tarifës dhe taksës komunale, lirohen:

1. Të gjithë anëtarët e familjes së ngushtë të dëshmorëve
2. Invalidëve të luftës
3. Veteranëve të luftës
4. Martirëve
5. Të zhdukurve dhe të rënëve civilë gjatë luftës
6. Të hendikepuarit, si dhe
7. Personat me aftësi të kufizuar.

Lirimi nga alineja e më sipërme bëhet vetëm sa i përket nxjerrjes dhe rregullimit të dokumentacionit që ka të bëjë me çështjet e invaliditetit dhe pensioneve përkatëse nga kategoria të cilës i takon parashtruesi i kërkesës apo anëtari i familjes së ngushtë të tij, si dhe dokumentacionit që ka të bëjë me shkollimin e obliguar prej atij parafillor dhe deri në shkallën e IX-të (nëntë) të përgatitjes shkollore apo shkallës tjetër që lejohet sipas ligjit përkatës.

Lirimi i kategorive të tjera të qytetarëve nga pagesa e ngarkesës, tarifës dhe taksës komunale

Neni 7

Nga ngarkesat, tarifat apo taksat komunale lirohen personat dhe anëtarët e familjeve të ngushtë të tyre, që janë në evidencën përkatëse dhe gëzojnë ndihmë sociale, vetëm sa i përket rregullimit të dokumentacioneve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtës në ndihmën sociale.

Nga pagesa e ngarkesës, tarifës dhe taksës komunale kategoria nga alineja e më sipërme lirohen edhe për sa i përket rregullimit të dokumentacionit shkollor që nga parashkollimi e deri në shkollën e IX-të (nëntë) të përgatitjes shkollore apo shkollës tjetër që lejohet sipas ligjit përkatës.

Mos lirimi nga pagesa e tarifës dhe taksës komunale

Neni 8

Të gjithë qytetarët me përjashtim të kategorive nga neni 6 dhe 7 i kësaj rregulloreje janë të obliguar të paguajnë ngarkesat, tarifat, dhe taksat komunale sipas kësaj rregullore.

Dokumentacioni që lëshohet për të gjithë qytetarët dhe që është për përdorim në botën e jashtme nuk lirohet nga pagesa e ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale nga kjo rregullore.

Çmimet e shërbimeve shëndetësore për qytetarë, persona fizikë dhe juridikë, po edhe për shtetas të huaj janë të përcaktuara në Udhëzimet përkatëse Administrative të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat akte kanë zbatim të drejtpërdrejtë.

KAPITULLI I II-të: DISPOZITAT NDËSHKUESE

Dënimet mandatorë, kundërvajtjet administrative, gjobat dhe masat tjera mbrojtëse

Neni 9

Disa nga veprimet në kundërshtim me ligjin dhe këtë rregullore, konsiderohen kundërvajtje, kjo në bazë të parimit ligjor-legalitetit: se askush nuk mund të jetë përgjegjës për kundërvajtje dhe as që mund t'i shqiptohet dënim përkatës nëse më parë vepra e kryer nuk ka qenë me ligj apo më akt tjetër normativ e paraparë si kundërvajtje.

Varësisht nga kundërvajtja e kryer të pandehurit do t'i shqiptohen ndëshkimet adekuate kundërvajtëse sipas Ligjit për Kundërvajtjet.

Lidhur me kundërvajtjet e kryera, inspektori kompetent komunal, apo organi tjetër i autorizuar komunal mund të inicioj procedurën përkatëse kundërvajtëse, me paraqitjen e kërkesës përkatëse tek gjykata kompetente që shqyrton çështjet kundërvajtëse apo gjykata tjetër me kompetencë reale dhe territoriale.

Varësisht nga rastet konkrete subjekteve afariste dhe personave të tjerë mund t'iu shqiptohen ndëshkimet përkatëse kundërvajtëse, duke përfshirë ndëshkimet kundërvajtëse administrative dhe gjobat si dhe masat tjera mbrojtëse për shkeljen e dispozitave të ligjit, dhe kësaj rregulloreje.

1. Dënimet mandatore

Neni 10

Dënimet mandatore përkatësisht gjobat janë masa ndëshkimore, të cilat mund t'i shqiptojë inspektori kompetent komunal, apo organi tjetër i autorizuar, varësisht nga rasti, të cilat iu shqiptohen të gjithë obliguesve të ngarkesave, tarifave dhe taksës e të cilët nuk i përmbushin obligimet përkatëse rreth pagesës adekuate të përcaktuar sipas kësaj rregulloreje.

Për eksploitim të egër (të pa ligjshëm) të zhavorrit, eksploatuesi jolegal gjobitet prej 20 € deri në 30 € për 1m³ të zhavorrit të eksploatuar, varësisht nga recidivizmi.

Nëse personi fizik apo juridik haset nga inspekcioni duke eksploatuar pa leje apo eksportuar zhavor apo rëre dhe i cili nuk posedon dokumentacionin përkatës, i shqiptohet dënimi mandator sipas paragrafit 2 të këtij neni ashtuqë zhavori-rëra i konfiskohet, nderkaq nëse personi i tillë nuk e paguan dënimin mandator po ashtu zhavori-rëra i konfiskohet dhe lënda më tej më fletparaqitje përkatëse i dergohet Gjykatës Themelore kompetente për vendosje të mëtejme meritore gjyqësore.

Ndotësit e ujërave të lumenjve, subjektet juridikë, ose fizikë gjobiten në shumën prej 20 € deri në 25 € varësisht nga masa e ndotjes dhe recidivizmi.

Neni 11

Lartësia e gjobës është dyfishi i tarifës dhe ngarkesës së përcaktuar për kryerjen e shërbimit përkatës, nëse ndryshe nuk përcaktohet me ligjin e veçantë.

Të gjitha limitet e dënimeve mandatore apo gjobave zbatohen drejtpërsëdrejti, të ndryshuara nga të lartcekurat, nëse ato janë të përcaktuara me ligjet e veçanta apo aktet e tjera të veçanta të Pushtetit qendror.

Afati për pagesën e të gjitha gjobave apo dënimeve të shqiptuara mandatore nga inspeksioni është 8 (tetë) ditë nga dita e shqiptimit apo në afatin tjetër ligjor të gjykatës nga dita e pranimit të vendimit gjyqësorë.

Në rast se ndëshkimet apo dënimet nuk paguhen në afatin e paraparë, nga inspektori kompetent inicohet procedura përkatëse pranë gjykatës kompetente.

Neni 12

Në rast të mos respektimit të afateve, direktivave dhe standardeve të paraqitura të lejeve të veprimtarisë do të zbatohen dispozitat ndëshkuese të ligjeve të veçanta që rregullojnë veprimtarinë e veçanta.

Përfundimisht nga zbatimi i 3 alineve të kësaj dispozite bën zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjeve dhe akteve të veçanta të pushtetit qendror që rregullojnë dënimet përkatëse.

Shqiptimi dhe inkasimi i gjobave në trafik si dhe gjobat tjera për shkeljen e rregulloreve komunale bëhet në pajtim me nenin 18 dhe 19 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

2. Ndëshkimet kundërvajtëse

Neni 13

Ndëshkimet kundërvajtëse-gjobat i shqipton gjykata kompetente që shqyrton çështjet e kundërvajtjeve, për rastet e shkeljeve të dispozitave përkatëse ligjore të ligjeve të veçanta, që ndërlidhen me tarifa, ngarkesa dhe gjoba, si dhe për shkeljen e dispozitave që ndërlidhen me dispozitat e Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat komunale, krejt këtë mbi bazë të Ligjit për Kundërvajtjet.

Nëse shkelën dispozitat e Ligjit për Ndërtimin, shkeljet e tilla përcaktohen në nenin 70 të tij, apo ndryshimet dhe plotësimet e ardhshme, ndërkaq nëse shkelën rregullat e tregtisë së brendshme, që ndërlidhen me dispozitat e shitjes së mallrave në ambient të hapur të subjekteve të pa regjistruara, shqiptohen gjobat sipas nenit 12 të Ligjit për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Tregtinë e brendshme nr.04/L-005.

3. Masat mbrojtëse

Neni 14

Për mosrespektimin e sigurisë publike, pastaj mos respektimin e standardeve higjienike, si dhe të shkeljes së dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të ligjeve të tjera që përligjojnë çështjet e ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale, mund të merren edhe masa mbrojtëse ndaj qytetarëve, personave fizik dhe personave juridik që ushtrojnë veprimtarinë përkatëse, krejt kjo në kuptim të ligjet përkatëse.

Komuna do të lëshojë një urdhër ndalimi të ushtrimit të veprimtarisë dhe do të bëjë mbylljen e përkohshme të veprimtarive (thertore, mishnore, shtëpi, ambulancë, dyqan ushqimor dhe të gjitha veprimtaritë tjera të kësaj natyre që paraqesin rrezik për shëndetin publik dhe sigurinë standarde) e që janë nën inspektim dhe deri sa të kryhen testet e nevojshme laboratorike si dhe deri sa të konstatohet se nuk ka rrezik për shëndetin publik.

Mos respektimi i higjienës, shëndetit publik dhe siguria standarde do të jetë arsye dënimi çdo herë dhe minimumi i dënimit do të jetë prej 100 € deri në maksimumin e dënimit prej 200 € varësisht nga shkalla e mosrespektimit.

Përfundim nga zbatimi i alineve të mëparshme të kësaj dispozite në zbatimin e drejtë për drejtë të ligjeve të veçanta dhe akteve tjera të veçanta të pushtetit qendror të cilat rregullojnë çështjen e ndëshkimeve kundërvajtëse dhe masave mbrojtëse.

KAPITULLI I III-të: ANKESAT DHE MBROJTJA JURIDIKE

Neni 15

Pala mund të ushtrojë ankesë ndaj vendimeve të lëshuara nga organet komunale kompetente, lidhur me tarifën dhe ngarkesat komunale sipas kësaj rregulloreje, krejtësisht në afatin e paraparë ligjor dhe në pajtim me Statutin e Komunës.

Procedura e ankesës duhet të jetë në përputhje me dispozitën e nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-28.

PJESA E VEÇANTË

KAPITULLI I IV-të: DISPOZITAT THEMELORE

NGARKESAT, TARIFAT, GJOBAT DHE TAKSAT TJERA TË LEJUARA SIPAS DREJTORIVE KOMUNALE

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Certifikatat dhe dokumentet zyrtare të Administratës së Përgjithshme komunale

Neni 16

Numri rendor tarifar	Përshkrimi	Vlera e taksës-Euro
16.1	Certifikata e lindjes.....	1 euro
16.2	Certifikata e martesës (certifikata e rregullt martesore)	2 ,,
16.3	Vertetimi-dokumenti nga arhiva për ekzistimin e kurorës-martese.....	2 ,,
16.4	Certif. e vdekjes	1 ,,
16.5	Certif. mbi statusin martesor (beqar, shkurorëzuar, i ve).....	5 ,,
16.6	Certif. për bashkësinë familjare	3 ,,
16.7	Certifikatë për lidhje martese (aftësia martesore-kapaciteti martesor me shtetas të huaj)	5 ,,
16.8	Certifikatë e shtetësisë	2 ,,
16.9	Certifikatë vendbanimi	2 ,,
16.10	Certifikatë për lajmërim-ç' lajmërim të vendbanimit-	3 ,,
16.11	Aktvdekja	5 ,,
16.12	Vërtetim që nuk është i regjistruar në LAL	3 ,,
16.13	Procesverbal për pranimin e atësisë.....	2 ,,
16.14	Deklarata me dy dëshmitarë	2 ,,

16.15	Dokumentet në kërkesë të autoriteteve të huaja	5 ,,
16.16	Regjistrimi i martesave në mesë të shtetasve të Kosovës (ceremonia e lidhjes së martesës apo kurorëzimi).....	10 ,,
16.17	Regjistrimi i martesave me shtetas të huaj	30 ,,
16.18	Përkthimi gjatë një ceremonie të martesës me shtetas të huaj	30 ,,
16.19	Përkthimi i dokumentacionit që sjellin qytetarët nga vendet e huaja (aktvendimet,aktgjykimet dhe certifikatat e ndryshme) ..	10 ,,
16.20	Aktvendimi për regjistrimin e me vonshëm në LA.....	10 ,,
16.21	Aktvendim për ndërrimin e emrit apo mbiemrit.....	10 ,,
16.22	Korrigjimet e emrit apo mbiemrit	2 ,,
16.23	Certifikata për germëzim	2 ,,
16.24	Konfirmim nacionaliteti apo identiteti	5 ,,
16.25	Konfirmimet dhe vërtetimet tjera (lindja, martesë, vdekje, statusi martesor, certifikata për lidhje martesë etj.) apo saktësia e dokumentit tek ZRGJC.....	3 ,,
16.26	Vërtetimi për humbje shtetësie	10 ,,
16.27	Vërtetimi për çështjen e aftësisë së veprimit	10 ,,

Taksat tarifore për shkresa, parashtrës dhe akte tjera

Neni 17

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës
17.1	Parashtrës dhe propozime	Pa taksë komunale
17.2	Kërkesa për të gjitha veprimet administrative	1 €
17.3	Vendimi apo Aktvendimi	2 €
17.4	Pëlqimi	1.50 €
17.5	Referenca	1.50 €
17.6	Certifikata	1.50 €
17.7	Vërtetimi i përshkrimit nga libri.....	7 €
17.8	Vërtetimi i origjinalit për një faqe formati A-4	0.50 €
17.9	Vërtetimi i origjinalit për një faqe formati A-3	1 €
17.10	Vërtetimi i dorëshkrimit	1 €
17.11	Certifikata mbi mjetet për jetës- mbajtja e prindërve për një person	5 €
17.12	Certifikata mbi mjetet për jetës për dy persona-prindër.....	10 €
17.13	Vërtetimi i deklaratës së dëshmitarëve	1 €
17.14	Deklarata	1 €
17.15	Autorizimi	3 €
17.16	Certifikata për shpenzime të varrimit.....	1 €
17.17	Përpilimi i garancisë për ardhje mysafir	1 €
17.18	Vërtetimi dhe dokumente tjera zyrtare	1 €

2. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

Ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarive afariste

Neni 18

Ngarkesat vjetore nga aktivitetet e biznesit dhe veprimtaritë tjera afariste sipas kësaj baze janë të klasifikuara në kategoritë si më poshtë:

Kategoria A: Bankat, hotelet, auto-shtëpitë, kompanitë e sigurimeve, minierat, përfaqësitë e ndërmarrjeve të jashtme, industria mekanike, metalurgjike dhe kimike, PTK, KEK-u, qendrat tregtare, bastoret në lokale të mbyllura, llogaritë, kazinotë, dhe lojërat tjera të fatit.

Tarifa vjetore 500,00 €.

Kategoria B: Motelet, gurthyeset, depot me shumicë, ndërmarrjet tregtare me shumicë, ndërmarrjet publike (ndërmarrjet e ujit dhe mbeturinave), shpeditoret, ndërmarrjet prodhuese të llaqeve, ngjitësit, restorantet-pishina, veprimtaria për thyeje të gurit dhënie e formës dhe finicionin.

Tarifa vjetore 400,00 €.

Tarifat vjetore për Pompat e karburanteve, qe hyjnë në kategorinë B, specifikohen si në vijim:

Pompat e karburanteve në qytetin e Klinës.....	300,00euro,
Pompat e karburanteve prej qytetit të Klinës deri të magjistralla Pejë-Prishtinë-Gjakovë.....	400,00euro,
Pompat e karburanteve në dalje të qytetit të Klinës në drejtim të Skenderajt.....	300,00euro,
Pompat e karburanteve në dalje të qytetit të Klinës në drejtim të Istogut.....	300,00euro, dhe
Pompat e karburanteve në viset rurale.....	200,00euro.

Kategoria C: Agjencitë turistike, ndërmarrjet projektuese, ndërmarrjet botuese dhe grafike, vetëshërbimet e mëdha, supermarketet, shtëpitë e mallrave, ndërmarrjet ndërtimore, poliklinikat shëndetësore, fabrikat e përpunimit të miellit, ndërmarrjet turistike, ndërmarrjet që merren me përpunimin e drurit dhe plastikës (dyer, dritare, panove reklamuese), ndërmarrjet për servisimin e automjeteve, restorantet, tregtia më pakicë e kompjuterëve dhe pajisjeve të TI, tregtia e pajisjeve sanitare, tregtia më pakicë e mobileve, veprimtaritë për dhënie e automobilave më qira, tregtia më pakicë e teknikës së bardhë, tregtia më pakicë e artikujve të imtë e ngjyrave, llaqeve dhe materialeve të tjera të sanitarisë së ujit dhe të rrymës, si dhe veprimtaria e shitjes së tepihëve dhe perdeve.

Tarifa vjetore 200,00 €.

Kategoria D: Barnatoret bujqësore, barnatoret shëndetësore, dyqanet në qendër të qytetit (Zona e parë), butikët, lokalet ushqimore, furrat e bukës, argjendarit, mishshitësit, auto-transportuesit, filialet e agjencive turistike dhe njësitë e ndërmarrjeve turistike, auto-shkollat, bujtinat, si dhe tregtia më pakicë e këpucëve dhe artikujve të tjerë të lëkurës.

Tarifa vjetore 120,00 €.

Kategoria E: Rrobaqepësit, salduesit, floktaret, berberët, fotografët, orëtarët, internet-kafetë, video-klubet, RTV mekanikët, radiot private, dyqanet në periferi (Zona e II-të), kombibusët, auto-parkingjet, gjellëtoret, qebaptoret, çajtoret, autolarjet, Tregtia më pakicë të mjeteve për traktorë dhe mjeteve tjera bujqësore, veprimtaritë e veterinarisë, bilardot, fotokopjet, dhe servisimi i telefonave apo kompjuterëve.

Tarifa vjetore 100,00 €.

Kategoria F: Kioskat në qytet (Zona e parë dhe e dytë), dyqanet në zonat rurale që nuk kanë qasje në rrugët regjionale, veprimtaritë e imta të biznesit dhe auto-taksitë, Veprimtaria për shitjen e kurorave, funeraleve dhe luleve, fitneset, veprimtaritë e ndryshme sportive, shërbimet postare-telefonike, Shtypshkronja dhe shtypshkrime tjera.

Tarifa vjetore 50,00 €.

Neni 19

Taksat tarifore vjetore sipas kategorive të veprimtarive paguhen lidhur me ushtrimin e veprimtarive afariste përkatëse.

Subjektet afariste të cilat veprimtarinë e tyre e zhvillojnë më tepër se në një lokal jashtë selisë paguajnë 50 % të taksës së përcaktuar të secilit lokal veç e veç.

Taksa për shërbime administrative me rastin e regjistrimit të bizneseve nuk paguhet. Nëse në ndërkohë këto veprime rregullohen me udhëzim të veçantë nga ministria kompetente vlejnjë drejtpërsëdrejti dispozitat e Udhëzimit të veçantë administrativ, (neni 8 i Ligjit nr.04/L-006 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare).

Bizneset dhe veprimtaritë e reja që regjistrohen për herë të parë, lidhur me ushtrimin e veprimtarive përkatëse, lirohen nga pagesa e ngarkesave, taksave tarifore në kohëzgjatje prej 18 muajve nga data e regjistrimit fillestar.

Ndërmarrjet prodhuese lirohen nga taksa për shërbime për 5 vitet e para të regjistrimit.

Ushtrimi i veprimtarive intelektuale private dhe taksat tarifore vjetore

Neni 20

Për ushtrimin e veprimtarive intelektuale profesionale paguhet taksa tarifore vjetore sipas kategorive përkatëse.

Ushtrimi i veprimtarive intelektuale profesionale bëhet sipas standardeve të vërtetuara dhe dëshmime kualifikuese dhe përgatitjes profesionale të lëshuara dhe të legalizuara nga organet kompetente shtetërore.

Kategorizimi i veprimtarive intelektuale private

Neni 21

Tarifat vjetore janë renditur sipas llojeve të veprimtarive private profesionale:

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës-Euro
21.1	Shkolla private	150,00 €
21.2	Avokatet	150,00 €
21.3	Stomatologet	150,00 €
21.4	Mjeku i specializuar	200,00 €
21.5	Mjeku i praktikës se përgjithshme	100,00 €
21.6	Këmbimoret e valutave	150,00€
21.7	Kontrollimi teknik i automjeteve	150,00€
21.8	Byrotë projektuese	150,00€
21.9	Kontabilistet	120,00 €
21.10	Auditorët	120,00 €
21.11	Përkthyesit	100,00 €
21.12	Veprimtaria e pavarur veterinare	100,00€
21.13	Tregtia me pakicë e videove dhe CD	100,00€
21.14	Këngëtarët (Live)	100,00 €
21.15	Kurset profesionale	100,00 €
21.16	Motrat medicinale	50,00 €
21.17	Këngëtarët (Dj)	50,00 €
21.18	Veprimtarit tjera	100,00 €.

KAPITULLI I V-të: TË HYRAT TJERA VETANAKE KOMUNALE

Neni 22

Të hyrat tjera vetanake të autorizuara në bazë të kësaj Rregulloreje nuk janë gjithëpërfshirëse, Komuna mund të vjelë dhe mbledhë edhe të hyra të tjera përmes tarifave dhe taksave përkatëse komunale, të cilat mund të lejohen me ndonjë ligj tjetër apo edhe në bazë të marrëveshjes me autoritetet qendrore.

Neni 23

Komuna mund të përcaktojë edhe taksa nga aktivitete të tjera të cilat janë të specifikuar më tutje në nenin 24, 25 që kanë të bëjnë me panot reklamuese, regjistrimin e automjeteve etj.

Panot reklamuese dhe taksa për ekspozimin e tyre

Neni 24

Për panot reklamuese në madhësi 1m x 1m që ekspozohen-vihen në pronën publike-komunale apo hapësira tjera publike në territorin e Komunës së Klinës paguhet taksa vjetore për 1(një) pano në vlerë prej 100,00 €.

Për panot me madhësi mbi 1m x 1m paguhet taksa vjetore në shumë prej 150,00 €.

Ngarkesat për pagimin e taksës paguhen me rastin e marrjes së lejes për vendosjen e panos reklamuese.

Taksa për panot reklamuese me ndriçim në qytet është 30 euro, ndërsa jashtë qytetit është 20 euro.

Vënja e panove reklamuese në autobus është 10 euro, ndërsa në automjete tjera më të vogla 5 euro.

Regjistrimi i automjeteve

Neni 25

Për regjistrimin e automjeteve në territorin e Komunës së Klinës, në zyrën kompetente komunale paguhet taksa vjetore siç vijon:

1. Për automjetet me peshë bartëse deri në 3 tonë paguhet taksa vjetore në shumë prej 10,00 €, dhe
2. Për automjetet me peshë mbi 3 tonë paguhet taksa vjetore në shumë prej 20,00 €.

Nga tarifa për leje të regjistrimit për mjete motorike, lirohen automjetet në pronësi të institucioneve shtetërore, përfaqësive diplomatike, emergjencës (makinat e zjarrfikësve, të ndihmës së shpejtë, si dhe makinat e komunitetit fetar për shërbesa fetare), ato të invalidëve të punës, civilë dhe ushtarakë. Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit, apo dokumenti tjetër që dëshmon pronësinë.

Neni 26

Koha e ripërtëritjes së ngarkesave dhe taksave

Të gjitha ngarkesat dhe taksat për ushtrimin e veprimtarive komerciale, profesionale duhet të ripërtërihen për çdo vit deri më 31 janar, ndërsa lejet e automjeteve nëse janë në kompetencë të komunës ripërtërihen me rastin e regjistrimit, krejt kjo sipas ligjit përkatës pozitiv dhe urdhëresave përkatëse të ministrisë së linjës kompetente.

3. Drejtoria e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë

KAPITULLI I VI-të: TARIFAT DHE TAKSAT PËR SHËRBIMET ADMINISTRATIVE TË REGJISTRIMIT TË NDRRIMEVE NË LIBRAT PUBLIKE SI DHE TAKSAT PËR SHËRBIMET KOMUNALE PROFESIONALE KADASTRALE DHE GJEODETE

Neni 27

Komuna e Klinës vendos tarifat dhe taksat unike për shërbimet administrative të regjistrimit të ndrrimeve të titullarve të palujtshmerive në librat publike nga zyrtari kompetent si dhe produktet kadastrale dhe gjeode te profesionale që kryhen nga Zyra Komunale Kadastrale, krejt kjo në zbatim të drejt për drejtë

nga Udhëzimet përkatëse Administrative të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor nr. 05/2012 për Tarifatat e Shërbimeve dhe të Produkteve Kadastrale të ofruara nga ZKK dhe Kompanitë gjeodete të licencuara, i miratuar me dt.11.06.2012 e i cili udhëzimi i referohet rregullimit dhe përcaktimit të tarifave për shërbimet e produkteve kadastrale të ofruara nga Zyrtat komunale kadastrale dhe Kompanitë gjeodete të licencuara, ngase tarifatat e tilla të Agjencisë Kadastrale të Kosovës janë unike në tërë Shtetin e Kosovës.

Regjistrimi i ndërrimit të titullarve të të drejtave pronësore-palujtshmërive dhe të drejtave të tjera mbi të nga ZKK-ja në Librat publikë të regjistrimit të palujtshmërive sipas transaksioneve valide pronësore

Neni 28

Për regjistrimin-ndërrimin e titullarëve të pronësisë, posedimit, në bazë të transaksioneve (shitblerjes) si dhe konstituimit të të drejtave tjera pronësore dhe reale mbi bazën e vlerave përkatëse të transaksionit paguhen taksat në vlerat e caktuara sipas nenit 2 të Udhëzimit Administrativ të MMPH nr. 08/2014 të datës 16.04.2014, i cili ka zbatim unik në nivel vendi.

Zyra Komunale Kadastrale për Regjistrimet tjera që kanë për bazë juridike dokumentacionin e dhuratës apo edhe dokumentet tjera juridike të ndërrimit të titullarit të pronësisë, zbatohen drejtpërsëdrejti dispozitat e nenit 3 deri në nenin 14 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr. 08/2014 të datës 16.04.2014, i cili ka zbatim unik në nivel vendi.

Neni 29

Zyra Komunale Kadastrale përkatësisht përgjegjësi i saj për Regjistrimin publik të ndërrimeve të titullarve të palujtshmërive për regjistrimin e transfereve të pronës, përkatësisht ndërrimin e titullarve të pronësisë, do të zbaton drejtpërsëdrejti tërë UA dhe në veçanti dispozitat e nenit 3 deri në nenin 14 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr. 08/2014 të datës 16.04.2014, i cili ka zbatim unik në nivel vendi si dhe Udhëzimi administrativ i MMPH nr.05/2012 i dt.11.06.2012 për Tarifatat e Shërbimeve dhe të Produkteve kadastrale të ofruara nga Zyrtat komunale kadastrale dhe Kompanitë gjeodete të licencuara.

4. Drejtoria e Inspektoratit

KAPITULLI I VII-të: TARIFAT DHE TAKSAT E INSPEKTIMIT

Neni 30

Kërkesa për pëlqim për kushtet minimale teknike-sanitare-higjienike të shoqërive tregtare dhe subjekteve të tjerë afarist për m².

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
30.1	Tarifa për lokalin deri në 30m ²	30 euro,
30.2	Tarifa për lokalin mbi 30m ² deri në 200m ² për çdo m ² nga	1 euro,
30.3	Tarifa për lokalin mbi 201 m ² për çdo m ² nga	0. 50euro.

Tarifat e inspektimeve tjera komunale në zonat rurale dhe zonat urbane

Neni 31

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
31.1	Inspektimi i pompave të benzinës, pishinave, Autolarjeve dhe serviseve	10 euro
31.2	Inspektimi i furrave gëlqerore, pompave etj.	10 euro
31.3	Inspektimi i ndotësve industrial dhe ndotësve të tjerë	10 euro
31.4	Inspektimi me kërkesë të palës jashtë qytetit	10 euro
31.5	Inspektimi me kërkesë të palës në qytet	5 euro
31.6	Lëshimi i vërtetimeve, certifikatave dhe dokumenteve të tjera.....	2 euro
31.7	Dhënia e pëlqimeve sanitare për pompa të benzinës, pishina etj.....	30 euro.

Inspektimi nga lëmi i ndërtimtarisë

Neni 32

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
32.1	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për persona fizikë.....	10 euro
32.2	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për persona fizikë.....	8 euro
32.3	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qyteti për subjekte afarist dhe institucione të tjera	20 euro
32.4	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për subjekte afariste dhe institucione të tjera	15 euro.

Inspektimi nga lëmi i tregut

Neni 33

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
33.1	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qyteti për persona fizikë	10 euro
33.2	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për persona fizikë	8 euro
33.3	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për subjekte afariste dhe institucione të tjera	20 euro
33.4	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për subjekte afariste dhe institucione të tjera	15 euro
33.5	Kërkesa për leje pune	10 euro
33.6	Kërkesa për asgjësim mallrash deri në vlerën prej 10.000,00euro	20 euro
33.7.	Kërkesa për asgjësim mallrash mbi vlerën prej 10.000,00euro	30 euro.

Inspektimi nga lëmi i shërbimeve komunale dhe publike

Neni 34

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
34.1	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për Persona fizikë	10 euro
34.2	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për persona fizikë.....	8 euro

34.3	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për subjekte afariste dhe institucione të tjera	20 euro
34.4	Kërkesa për kontrollim inspektuese në qytet për subjekte afariste dhe Institucione të tjera	15 euro
34.5	Kërkesa për dalje në terren të PTK-ës, KEK-ut jashtë qytetit	100 euro
34.6	Kërkesa për dalje në terren të PTK-së, KEK-ut në qytet	50 euro.

Inspektimi nga lëmi sanitar

Neni 35

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
35.1	Kërkesa për kontrollime sanitare inspektuese jashtë qytetit për persona fizikë	10 euro
35.2	Kërkesa për kontrollime sanitare inspektues në qytet për persona fizikë	8 euro
35.3	Kërkesa për kontrollime sanitare inspektuese jashtë qytetit për subjekte afariste dhe institucione të tjera	20 euro
35.4	Kërkesa për kontrollime sanitare inspektuese në qytet për subjekte afariste dhe institucione të tjera	15 euro
35.5	Kërkesa për asgjësim mallrash nga lëmia sanitare deri në vlerën prej 10.000,00euro caktohet taksa në vlerë prej	20 euro
35.6	Kërkesa për asgjësim mallrash nga lëmia sanitare mbi vlerën prej 10.000,00euro caktohet taksa në vlerë prej	30 euro
35.7	Kërkesa për asistim për zhvarrosje të mbetjeve mortore dhe leshimi i aktit përcjellës, caktohet taksa në vlerë prej	50 euro.

Inspektimi nga lëmi i bujqësisë dhe ambientit

Neni 36

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
36.1	Kërkesa për kontrollim dhe inspektim nga lëmi i bujqësisë jashtë qytetit për persona fizikë	10 euro
36.2	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për persona fizikë	8 euro
36.3	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qyteti për subjekte afariste dhe institucione të tjera.....	20 euro
36.4	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për subjekte afariste dhe institucione të tjera	15 euro
36.5	Parashtrësia të tjera	1 euro
36.6	Kërkesa për asgjësim mallrash nga lëmia e bujqësisë dhe ambientit deri në vlerën prej 10.000,00 euro caktohet taksa prej	20 euro
36.7	Kërkesa për asgjësim mallrash nga lëmia e bujqësisë dhe ambientit mbi vlerën prej 10.000,00euro caktohet taksa prej	30 euro.

5. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

KAPITULLI I VIII-të: NGARKESAT DHE TAKSAT PËR RREGULLIMIN E TOKËS

Neni 37

Në bazë të Planit Zhvillimor Komunal-PZHK-al, pastaj Planit Zhvillimor Urban-PZHU-an si dhe Planit Rregullues Urban-PRRU-an dhe rregullativës tjetër urbane, janë të caktuara zonat si më poshtë:

Zona e I-rë: Përfshinë hekurudhën për Prizren deri tek ura e hekurudhës në Klinë, lumin Klina e deri te bashkimi i lumit Klina me Drinin e Bardhë, deri tek ura e hekurudhës për Pejë, prej urës mbi lumin Drini i Bardhë, hekurudhës se Pejës deri te bashkimi me hekurudhë të Prizrenit.

Zona e II-të: Shtrihet përtej lumit Klina, Lagja Fusha e Klinës, Lagja Arbëria (ish- Përlina) deri të magjistranja Prishtinë-Pejë, Lagja te Malishgani (ZK Stupovi) dhe shtrihet përgjatë lumit Klinë deri te Zona industriale, dhe vazhdon deri të hekurudha për Fushë Kosovë, pastaj hekurudhës për Prizren e deri të Ura e Hekurit mbi lumin Klinë, dhe shtrihet prej rrugës për Zllakuqan hekurudhës për Pejë deri të ura mbi lumin Drini i Bardhë e deri të varrezat e romëve.

Zona e III-të: Shtrihet përtej lumit Drini i Bardhë.

Kjo zonë shtrihet prej rrugës Klinë-Zllakuqan deri të varrezat e romëve, prej këtyre varrezave e deri të rezervuari i ujit, e prej këtij rezervuari e deri te rruga për Gjurgjevik të Vogël dhe lëshohet rrugës për Skenderaj dhe vije në rrugën “Dëshmorët e Kombit” e deri të binarët e hekurudhës për në Pejë e deri të rruga për Zllakuqan.

Zona e IV-të: Përfshinë, fshatrat, vendbanimet dhe zonat rurale.

Tarifat për rregullimin e tokës ndërtimore dhe jo ndërtimore

Neni 38

Taksa administrative për dhënien e Lejës ndërtimore caktohet në pajtim me Ligjin për Ndërtimin nr. 04/L-110 dhe Udhëzimin Administrativ të MMPH-or nr. 22/2012 të dt. 19.12.2012 për lëshimin e Lejës së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, i cili udhëzim ka zbatim unik në nivel vendi.

Taksa nga paragrafi i mëparshëm vlen për objektet që nuk matën me metër katëror ose që përmbajnë pjesë që nuk matën më metër katëror dhe që kanë karakter unik. Kjo taksë dhe formula e llogaritjes së saj është caktuar për Komunën e Klinës më Vendimin e veçantë të MMPH-or nr. 043/2013 të dt. 15.03.2013, dhe ajo taksë për Lejet e ndërtimit është caktuar që të jetë 2.13 € për metër katëror.

Tarifat për rrënimin-demolimin e objekteve

Neni 39

Shpenzimet e rrënim-it-demolimit si dhe ato për rregullimin e pronës i bartë investitori ose ndërtuesi pa leje, i cili nuk ka poseduar leje për ndërtim nga organi kompetent i komunës për punët e ndërtimit.

Ngarkesa për demolimin e objektit të ndërtuar pa leje caktohet.....8,00euro/m²
Ngarkesa për rregullimin e pronës pas demolimit caktohet.....4,00euro/m².

Neni 40

Për objektet që ndërtohen më donacione nga organizatat e ndryshme nuk aplikohet taksa administrative.

Taksat tarifore nga lëmia mjedisore përcaktohen me Udhëzimin Administrativ nr. 1/2005 për Tarifat e Shërbimeve nga Lëmia mjedisore, të cilat kanë zbatim unik të drejt për drejtë.

Pagesa e komunalive për objektin e përkohshëm

Neni 41

Pagesa e taksës në emër të komunalive për objektet e përkohshme bëhet një herë më rastin e marrjes së lejes, dhe atë si vijon:

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Euro
41.1	Zona e I-rë	3 €
41.2	Zona e II-të	2 €
41.3	Zona e III-të	1 €

Ndërrimi i destinimit të objektit

Neni 42

Për ndërrimin e destinimit të objektit prej objektit banesorë në lokal afarist paguhet rregullimi i zonës 2 € për m².

Për marrjën e lejes së ndërtimit, shfrytëzimit dhe vendimit për rregullimin e zonës paguhet taksat siç vijon:

Numri rendor tarifor.	Përshkrimi	Euro
42.1	Lëshimi i lejes për ndërtim	25,00 €
42.2	Leja e shfrytëzimit	25,00 €
42.3	Lëshimi i vendimit për rregullimin e zonës përkatësisht leja urbanistike	25,00 €
42.4	Referenca e ndërtimit	25,00 €

Lëshimi i lejes për fshat për depo, punëtori, sera etj. paguhet 50% nga çmimi i i zonës së katërtë.

Për objekte në rindërtim që janë të dëmtuara si pasojë e luftës dhe objektet e djegura janë të liruara nga pagesa e tarifës, pronarët që posedojnë leje ndërtimi.

Lirohen nga pagesa e taksave për leje të ndërtimit, ndërtuesit e stallave të bagëtive në fshatra.

Pagesa e tarifave dhe ngarkesave për leje ndërtimi bëhet para marrjes së vendimit për lejimin e ndërtimit të objektit, kurse tarifat për kërkesa më rastin e dorëzimit të kërkesës.

Tarifat për rindërtim, sanime, adaptime dhe aneksime

Neni 43

Taksa administrative për sanime, adaptime, renovime, fasadime, caktohet në vlerën e 50% të taksës së ndërtimit të të gjitha llojeve të objekteve si të ato private po ashtu edhe të ato që ndërtohen më koncesion apo partneritet publiko-privat.

Taksa për Lejet e aneksimit dhe mbindërtimit llogaritet sipas Udhëzimit Administrativ të MMPH-or nr. 22/2012 të dt.19.12.2012 mbi Taksat administrative për leshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Tarifa për rindërtimin e objektit në themele të vjetra, në të njëjtin truall, lirohet për aq m² që ka poseduar në lejen e ndërtimit.

Ngarkesat dhe tarifat për dhënie në shfrytëzim të pronës publike-komunale urbane për qëllime komerciale

Neni 44

Personat juridikë dhe fizikë nëse janë shfrytëzues të pronës-tokës komunale publike, duke bërë grupimin dhe vënien e rrjeteve përkatëse kabllore dhe ndërtime tjera në token komunale, janë subjekte të ngarkesës më tarifën përkatëse.

Për shfrytëzimin e tokës komunale publike dhe asaj urbane si dhe grupimi i saj për ndërtimin e kanalizimeve, vendosjen e kabllore energjetike të postës dhe telekomunikacionit për nevoja të PTK-së, KEK-ut si dhe ndërmarrjeve të tjera për shtrirjen e kabllorëve të tensioneve të ndryshme për ndërtimin e rrjetit energjetik, pastaj atij telefonik ajror dhe tokësor, ujësjellësit, ngrohjes, kanalizimeve fekale, vendosjen e antenave të ndryshme telefonike asaj mobile dhe fikse dhe objekteve të tjera të ngjashme caktohet tarifa për metër gjatësi.

Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore caktohet tarifa.....2,00 euro për metër gjatësi.

Tarifa ditore, për shfrytëzimin e lokaleve-objekteve afariste në pronën komunale, sipas vendimit përkatës të organit kompetent, caktohet siç vijon:

Numri rendor tarifor.	Përshkrimi	Euro
44.1	Vendi i shfrytëzuar për kamping, parkingje sezonale etj.	0.10 € m ² -ditë,
44.2	Shfrytëzimi i hapësirës së tregut për shitjen e mallrave për ditët e tregut	3 €-në ditë,
44.3	Për mallra të imta për ditët e tregut	1 €-në ditë.

Tarifat dhe ngarkesat për shfrytëzimin e përkohshëm të tokave komunale-hapësirave publike

Neni 45

Për shfrytëzimin e përkohshëm të tokave tjera në pronësi komunale (hapësirat publike) caktohet tarifa vjetore për m² sipas zonave, siç vijon:

Zona e Parë.....	1 € m ² -në vit,
Zona e dytë.....	0.70 € m ² -në vit,
Zona e tretë.....	0.50 € m ² -në vit, dhe
Zona e katërtë.....	0.10 € m ² -në vit.

Tarifat dhe ngarkesat për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës komunale-hapësirës publike për vendosjen e objekteve të përkohshme

Neni 46

Për shfrytëzimin e tokës komunale-hapësirës publike për vendosjen e objekteve të përkohshme për qëllime komerciale dhe banimi caktohet tarifa vjetore, sipas zonave, siç vijon:

1. Për qëllime komerciale:

Zona e I-rë.....	8,00euro m ² në vit,
Zona e II-të.....	4,00euro m ² në vit,
Zona e III-të.....	3,00euro m ² në vit, dhe
Zona e IV-të.....	2,50euro m ² në vit.

2. Për qëllime banimi:

Zona e I-rë.....3,00euro m² në vit,
Zona e II-të.....2,00euro m² në vit,
Zona e III-të.....1,00euro m² në vit, dhe
Zona e IV-të.....0,50euro m² në vit.

Tarifat dhe ngarkesat tjera për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës komunale publike-hapësirës publike për vendosjen e aparateve, shkallëve dhe stabilimenteve të ndryshme

Neni 47

Tarifat dhe ngarkesat për vendosjen e aparateve, shkallëve dhe stabilimenteve të ndryshme, automjeteve të ndryshme lëvizëse, shkallëve dhe ekspozimeve të mallrave në tokën komunale hapësirat publike caktohet varësisht nga lloji i mjetit dhe atë për aparat, pastaj m² apo si tarifë ditore ose mujore dhe atë siç vijon:

1. Vendosja e pajisjeve dhe aparateve për akulllore sipas zonave:

Zona e I-rë.....10,00euro për aparat,
Zona e II-të.....8,00euro për aparat,
Zona e III-të.....5,00euro për aparat, dhe
Zona e IV-të.....2,00euro për aparat.

2. Vendosja e shkallëve në tokën komunale publike-hapësirën publike caktohet tarifa vjetore prej 30,00euro m².

3. Shfrytëzimi i tokës komunale publike para objektit në të cilin kryhen shërbime tregtare hoteliere caktohet tarifa mujore, sipas zonave, si vijon:

Zona e I-rë.....10,00euro m²
Zona e II-të.....5,00euro m²
Zona e III-të.....1,00euro m² dhe
Zona e IV-të lirohet nga pagesa.

4. Tarifat ditore për shfrytëzimin e pronës komunale publike përcaktohen sipas zonave dhe atë:

Zona I-rë 20,00 €
Zona II-të.....10,00 €
Zona III-të.....05,00 €”.

5. Shfrytëzimi i tokës komunale publike hapësirës publike për vendosjen e automjetit lëvizës për shitjen e ushqimit të shpejtë caktohet tarifa ditore në lartësi prej 5,00euro në ditë.

6. Shfrytëzimi i tokës komunale publike hapësirës publike për vendosjen e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm caktohet tarifa ditore për tendë prej 1,00euro për m².

7. Shfrytëzimi i tokës komunale publike hapësirës publike për vendosjen e lojërave të fëmijëve caktohet tarifa ditore në lartësi prej 3,00euro në ditë.

8. Shfrytëzimi i tokës komunale hapësirës publike për vendosjen e gjeneratorëve statikë caktohet tarifa mujore sipas zonave, si vijon:

Zona e I-rë.....8,00euro m²
Zona e II-të.....5,00euro m²
Zona e III-të.....2,00euro m² dhe
Zona e IV-të nuk tarifohe dhe lirohet nga pagesa.

9. Shfrytëzimi i tokës komunale publike hapësirës publike për ekspozimin e mallit ambalazh dhe mallit tjetër të ngjashëm caktohet tarifa mujore sipas zonave, si vijon:

Zona e I-rë.....10,00euro m²
Zona e II-të.....8,00euro m²
Zona e III-të.....5,00euro m² dhe
Zona e IV-të2,00euro m².

10. Për shfrytëzimin e tokës komunale publike hapësirës publike për **kamping, parkingje sezonale** etj. të ngjashme caktohet tarifa prej 0.10euro për m² në ditë.

11. Për shfrytëzimin e tokës komunale publike hapësirës publike për **shitjen e mallrave të ndryshme për ditët e tregut** caktohet tarifa prej 3,00euro në ditë.

12. Për shfrytëzimin e tokës komunale publike hapësirës publike për **shitjen e mallrave të imta ditëve të tregut** caktohet tarifa prej 1,00euro në ditë.

13. Shfrytëzimi i tokës komunale hapësirave publike për qëllime të **parkimit të automjeteve** caktohet tarifa në vlerë prej 0.30euro për orë.

Dhënia në shfrytëzim afatgjatë me qira e tokës komunale dhe paluajtshmërive tjera komunale

Neni 48

Toka komunale dhe paluajtshmëritë tjera komunale mund të jepen në shfrytëzim afatgjatë më qira sipas procedurës përkatëse ligjore të paraparë nga Ligji i Prokurimit publik dhe në afatet e parapara më Ligjin për Dhënie dhe Pronës komunale në shfrytëzim dhe këmbimin e saj, po edhe dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Ngarkesat për dhënie në shfrytëzim me qira të tokës dhe paluajtshmërive tjera komunale caktohet sipas tarifave përkatëse:

1. Qiraja për dhënie e tokës komunale, pronë e Komunës, për ndërtimin e ndërtesave individuale caktohet më tarifën mujore prej 0,30euro për m²,

2. Qiraja për dhënie në shfrytëzim të objektit për banim-banesës, pronë e Komunës caktohet tarifa mujore prej 0,30euro për m², dhe

3. Qiraja për dhënie në shfrytëzim të lokalit afarist-komercial, pronë e Komunës caktohet tarifa mujore prej 5,00euro për m².

Tarifat dhe taksat tjera për kryerjen e shërbimeve administrative nga lëmia e urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit

Neni 49

Tarifat dhe taksat tjera nga lëmia e urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit caktohen si vijojn:

1. Vërtetimi 5 €
2. Certifikata..... 5 €
3. Konstatimi..... 5 €
4. Pelqimi komunal..... 100 €
5. Leja Mjedisore komunale-LMK..... 100 €.

6. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Taksat dhe ngarkesat për eksploatin e resurseve natyrore

Neni 50

Veprimtaritë e minierave, gurthyesve dhe eksploatesve të tjerë të burimeve natyrore përveç lejes së lëshuar nga Autoriteti qendror kompetent kërkohet leje e veprimit (operimit) brenda kufijve të Komunës.

Taksat e referuara në këtë seksion duhet t' i paguhen Komunës për dhënie e kësaj leje, në bazë të ripërtëritjes vjetore.

Taksat e aplikueshme vjetore janë:

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Euro
50.1	Për zhavorr dhe rërë	1 € për m ³
50.2	Për gurë gëlqerorë pa minim	0.25 € për m ³
50.3	Për gurë gëlqerorë me minim	0.50 € për m ³
50.4	Për gurë artizanale	0.50 € për m ³ .

Sa i përket qirasë së shfrytëzimit të pasurive natyrore Komuna do të grumbullojë, depozitohet dhe ndajë të hyra në përputhje me dispozitat dhe instruksionet administrative lokale dhe të AQF-së të përmendur më lartë.

Ndërrimi i destinimit dhe kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore

Neni 51

Shuma e kompensimit për ndërrimin e destinimit varet nga klasifikimi i tokës sipas klasave, dhe atë si vijon:

1. Klasa e I-rë deri në klasën e IV-të, kompensimi do të jetë1.00 për m²,
2. Klasa e V-të deri në klasën e VI-të, kompensimi do të jetë.....0.75euro për m², dhe
3. Klasa e VII-të deri në klasën e VIII-të, kompensimi do të jetë.....0.50euro për m².

Të gjitha kushtet, kriteret dhe procedimet tjera janë të caktuara në Udhëzimin Administrativ të MBPZH nr. 41/2006 për Ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Çdo ndryshim i Udhëzimit administrativ apo edhe udhëzimi i ri ka zbatim të drejt për drejtë deri në plotësimet dhe ndryshimet e rregullores komunale.

Taksat tjera tarifore të Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Neni 52

Taksat tarifore për qarkullimin e kafshëve të gjalla si dhe certifikatat përkatëse shëndetësore përcaktohen në Udhëzimin Administrativ të MBPZHR nr.17/2005 për Qarkullimin e Kafshëve të gjalla brenda territorit të Kosovës, i cili ka zbatim unik.

Taksat tarifore për shërbime të tjera caktohen siç vijojnë:

1. Pëlqimi për Licencim të Shitjes se plehrave minerale, pesticideve caktohet taksa tarifore në vlerë prej 10,000euro.
2. Vërtetimi për veprimtari bujqësore caktohet taksa tarifore në vlerë prej 5,000euro.
3. Vërtetimi për fermer caktohet taksa tarifore në vlerë prej 3,000euro.
4. Certifikata e regjistrimit të fermerit në vlerën prej 2,00 €.

Sa i përket të hyrave tjera nga lëmia e pylltarisë do të vlejnjë taksat tarifore të kësaj lëmie të caktuara në bazë të Ligjit nr 03/L-153 për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Pyjet e Kosovës nr.2003/3 si dhe në bazë të çmimoreve të përcaktuara me UA të veçanta nga kjo lëmi, të cilat kanë zbatim unik të drejt për drejt.

6. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor të QKMF dhe QMF-re

Neni 53

Çmimorja e bashkëpagesave është e përcaktuar më Udhëzimin Administrativ nr.04/2007 të Ministrisë së Shëndetësisë për mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetjake.

Sipas këtij akti ligjor caktohen tarifat dhe taksat e shëndetësisë primare, për shërbimet shëndetësore, dhe ato stomatologjike.

Shërbimet shëndetësore të nivelit primar-parësor:

Numri rendor tarifor	Përshkrimi	Euro
53.1	Ekzaminimi mjekësor në punktet QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike, ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë,	1.0 euro
53.2	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të mjekut të familjes,	2.0 ,,
53.3	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të mjekut të familjes,	5.0 ,,
53.4	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente,	6.0 ,,
53.5	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike,	0.3 ,,
53.6	Ultrazëri standard,	2.0 ,,
53.7	Radiografia,	2.0 ,,
53.8	EKG,	0.5 ,,
53.9	Analizat laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina,	1.0 ,,
53.10	Analizat laboratorike (komplet),	3.0 ,,
53.11	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve mjekësore,	1.0 ,,
53.12	Audiaograma,	1.0 ,,
53.13	Shpëlarja e veshit,	1.0 ,,
53.14	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos rasteve emergjente,	1.0 ,,
53.15	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente,	1.0 ,,
53.16	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë),	3.0 ,,
53.17	Trajtimi ditor më infuzione në institucionin shëndetësor,	1.0 ,,
53.18	Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve,	18.0 ,,
53.19	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve Shëndetësore,	18.0 ,,
53.20	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore,	5.0 ,,
53.21	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj. për një orë.	25.0 ,,

Tarifat dhe çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet stomatologjike të nivelit parësor:

Neni 54

54.1	Vizita e parë stomatologjike	1.0 ,,
54.2	RTD i dhëmbit	1.5 ,,
54.3	Mbushje e përhershme më amalgamë	4.0 ,,
54.4	Mbushje e përhershme me kompozitë	5.0 ,,
54.5	Shërimi biologjik i dhëmbit më mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.0 ,,
54.6	Amputim vital i pulpës më mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.0 ,,
54.7	Extirpimi vital i pulpës më mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.0 ,,
54.8	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.0 ,,
54.9	Extirpimi i pulpës më mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.0 ,
54.10	Terapia e kanalit të infektuar më mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.0 ,,
54.11	Rindërtimi konservativ i dhëmbit më mbushje të përhershme	6.0 ,,
54.12	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.0 ,,

54.13	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.0 „
54.14	Vulosja e fisurave	1.0 „
54.15	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.0 „
54.16	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurësve të dhëmbëve me ultratingull)	3.0 „
54.17	Kiretazha e xhepave pradontal (një dhëmbë)	1.0 „
54.18	Nxjerrja e dhëmbit	1.5 „
54.19	Incizioni intra dhe extra oral	1.5 „
54.20	Heqja e kurorës më anë të prerjes	1.0 „
54.21	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.5 „

Lirimi nga pagesat e lartcekura bëhet në bazë të nenit 22 të Ligjit për Shëndetësinë nr. 2004/4 si dhe nenit 5 të Udhëzimit administrativ nr. 04/2007 të dt.24.09.2007.

Në rast të ndryshimeve dhe plotësimeve ligjore si dhe udhëzimit administrativ të më vonëshme, si dhe zbrazëtirës juridike eventuale të kësaj rregullore sa i përket tarifave, taksave dhe bashkëpagesave të kësaj lëmie, vlejné drejt për së drejti dispozitat pozitive të nivelit ministror të linjës.

Neni 55

Për lëshimin e certifikatave të ndryshme shëndetësore caktohen tarifat unike sipas Udhëzimit Administrativ për Shëndetësi nr. 04/2011 i cili ka zbatim unik të drejt për drejt në Kosovë, dhe se tarifat e atij udhëzimi janë pjesë përbërëse e zbatueshme edhe për institucionet shëndetësore në Komunën e Klinës.

8. Drejtoria e Arsimit

Bashkëpagesat në arsim

Neni 56

Të gjitha bashkëpagesat, tarifat dhe taksat për shërbime komunale të arsimit, konsiderohen si të hyra vetjake të institucionit përkatës arsimor të komunës.

Trajtimi, kontabiliteti, raportimi, monitorimi dhe verifikimi i këtyre bashkëpagesave bëhet në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit.

Taksat tarifore për shërbimet tjera që bien në kuadër të lëmit të arsimit caktohen siç vijon:

1. Participimi në baza mujore për çerdhe dhe kopshte të fëmijëve caktohet në vlerë prej 20,00euro për muaj.
2. Taksa tarifore për dëftesën e shkollës së mesme caktohet në vlerë prej 0,50euro.
3. Taksa tarifore për diplomën e shkollës së mesme caktohet në vlerën prej 1,00euro.
4. Taksa tarifore për nxjerrjen duplikat të diplomës së shkollës së mesme caktohet në vlerën prej 5,00euro.

9. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente

Neni 57

Për shërbimet administrative që kryhen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente paguhen taksat tarifore përkatëse.

Shërbimet administrative për lëshimin e pëlqimeve nga Shërbimi i Zjarrfikësve, caktohen si vijojnë:

1. Pëlqimet për shërbimet e zjarrfikësve në objektet e banimit kolektiv në sipërfaqe prej 200 deri në 500m² caktohet taksa tarifore në vlerë prej 30,00euro.
2. Pëlqimet për shërbimet e zjarrfikësve në objektet industriale në sipërfaqe prej 200m² caktohet taksa tarifore në vlerë prej 15,00euro.

3. Pëlqimet për shërbimet e zjarrfikësve në objektet industriale në sipërfaqe mbi 200m² caktohet taksa tarifore në vlerë prej 30,00euro.

Pëlqimet mbi gjendjen teknike të pajisjeve për mbrojtjen nga zjarri

Neni 58

Për lëshimin e pëlqimeve dhe vërtetimeve përkatëse të gjendjes së pajisjeve për mbrojtjen nga zjarri caktohen taksat tarifore siç vijojnë:

1. Për aparatet e mbrojtjes nga zjarri në objektet ekonomiko-afariste caktohet taksa tarifore në vlerë prej 5,00euro.
2. Për aparatet e mbrojtjes nga zjarri në stacionet e karburanteve caktohet taksa tarifore në vlerë prej 7,00euro.
3. Për aparatet e mbrojtjes nga zjarri në objektet industriale caktohet taksa tarifore në vlerë prej 10,00euro.
4. Për aparatet e mbrojtjes nga zjarri në objektet kolektive-banesore caktohet taksa tarifore në vlerë prej 3,00euro.

Taksat tarifore për pëlqime dhe shërbime tjera

Neni 59

Për lëshimin e Pëlqimit për kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit caktohet taksa tarifore në vlerë prej 15,00euro.

Për shërbimet e furnizimit me ujë më cisternë caktohet taksa tarifore në vlerë prej 0.002 euro për 1 litër.

10. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Neni 60

Për shfrytëzimin e objekteve të sportit paguhen taksat tarifore dhe atë siç vijon:

1. Për shfrytëzimin e Hallës sportive për aktivitete politike caktohet taksa tarifore në vlerë prej 50,00euro për orë.
 2. Për shfrytëzimin e Hallës sportive nga ana e subjekteve të tjerë për aktivitete sportive caktohet taksa tarifore në vlerë prej 10,00euro për orë.
- Për shfrytëzimin e objekteve të kulturës Bibliotekës komunale publike si dhe anëtarësimin përkatës caktohen taksat tarifore vjetore, siç vijojnë:

1. Anëtarësimi i nxënësve të shkollave fillore caktohet taksa tarifore në vlerën prej 1,50euro në vit.
2. Anëtarësimi i nxënësve të shkollave të mesme caktohet taksa tarifore në vlerën prej 2,00euro në vit.
3. Anëtarësimi për studentë caktohet taksa tarifore në vlerën prej 3,00euro në vit.
4. Anëtarësimi për qytetarë caktohet taksa tarifore në vlerën prej 6,00euro në vit.

Për shfrytëzimin e objektit të Qendrës së Kulturës “Jehona e Dukagjinit” caktohen tarifat dhe taksat si në vijim:

1. Për tubime politike.....100,00 €; (cmim fiks)
2. Për shfaqje të ndryshme si: filma, koncerte, shfaqje të tjera teatrale etj, caktohet tarifa 20% e cmimit të teresishem të biletave të shitura.
3. Për aktivitete të tjera caktohet tarifa.....20,00 € për 1 orë.

Tarifat e taksat e mësipërme nuk i referohen tubimeve përkatëse mortore, takimeve që organizohen nga kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, si dhe takimet tjera që organizohen për nevoja publike të komunës.

Për shfrytëzimin e fushës së sportit të KF "Dukagjini" caktohet tarifa dhe taksa fikse në lartësi prej 15,00 € për 1 orë shfrytëzimi.

Taksat tarifore për shfrytëzimin e shërbimeve nga Arkivi historik

Neni 61

Për kryerjen e shërbimeve administrative të fotokopjimit dhe ekstraktet e dokumenteve që nxirren nga arkivi historik caktohen tarifat dhe taksat, si në vijim:

Lëshimi i certifikatave apo vërtetimeve të ndryshme.....2,00 €.

Tarifat dhe taksat për shërbimet e fotokopjimit sipas faqeve dhe formatit caktohen si në vijim:

Fotokopjimi i dokumenteve:

- a.) Një faqe A4.....0.10 €;
- b.) Një faqe A3.....0.20 €;
- c.) Një faqe A0.....1.00 €.

Kërkesat për nevoja personale fizike:

- a.) Një faqe A4.....0.50 €;
- b.) Një faqe A3.....0.70 €;
- c.) Një faqe A0.....1.00 €.

Për institucionet:

- a.) Një faqe A4.....0.60 €;
- b.) Një faqe A3.....0.70 €;
- c.) Një faqe A0.....2.50 €.

Shtypja e dokumenteve aty ku nuk është i mundur kopjimi caktohet tarifa dhe taksa:

Për një faqe.....10.00 €.

Shfrytëzimi i materialit arkivor në procedurë të veçantë të sigurimit, më përcjellje të punëtorit arkivor jashtë arkivit për një ditë caktohet në vlerën prej 15.00 €.

Kategoritë e liruara nga pagesa e tarifave të shërbimeve të kryera nga ana e Arkivit historik

Neni 62

Kategoritë e personave që lirohen nga pagesa e tarifave dhe taksave për shërbimet që kryhen nga Arkivi historik janë:

1. Familjet e dëshmorëve (paraardhësit apo pasardhësit e drejtpërdrejtë);
2. Invalidët e luftës;
3. Veteranët e luftës;
4. Familjet e viktimave civile (paraardhësit apo pasardhësit e drejtpërdrejtë);
5. Personat më aftësi të kufizuar, si dhe
6. Familjet në asistencë sociale.

Gjobat nga trafiku

Neni 63

Gjobat e shqiptuara për shkelje kundërvajtëse në trafik brenda territorit të Komunës së Klinës, janë të hyra vetjake dhe i takojnë Komunës së Klinës, siç e kanë të njëjtin tretman edhe gjobat tjera për shkeljet e rregulloreve komunale.

Transferet bëhen në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë dhe do të i përfshijnë pagesat që bëhen përmes Policisë së Kosovës dhe gjykatave kompetente si rezultat i vendimeve gjyqësore.

KAPITULLI I IX-të: DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 64

Në rast të zbrazëtirës juridike nga rregullativa komunale lëndore apo kolizionit të saj me dispozitat përkatëse sistemore ligjore zbatohen drejtëpërsëdrejti dispozitat sistemore ligjore që rregullojnë çështjen e përcaktimit të ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale, si dhe ato të akteve të tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe dispozitat tjera të Udhëzimeve përkatëse administrative të Ministrive përkatëse të linjës kompetente.

Hyrja në fuqi e Rregullorës dhe ndryshimet e plotësimet e saja

Neni 65

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas ditës së miratimit nga Kuvendi i Komunës. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje bëhet si në procedurën për miratimin e saj.

Zbatimi dhe mbikëqyrja e Rregullores

Neni 66

Zbatimi i kësaj Rregulloreje bëhet nga të gjitha drejtoritë e Komunës së Klinës dhe organet e tjera kompetente administrative komunale, që janë të obliguara për zbatimin e taksave, tarifave, gjobave dhe ngarkesave tjera komunale sipas ligjit dhe kësaj Rregulloreje.

Kryetari i Komunës bën mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Rregulloreje.

Publikimi dhe transparenca e Rregullores

Neni 67

Për njoftim Rregullorja publikohet në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës, si dhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Klinës, në kuadër të portalit qeveritar, një kopje MAPL-ës në Prishtinë dhe një arkiva.

Nr. 01-434-5712/2014
Klinë, më dt. 26.12.2014.

KUVENDI I KOMUNËS NË KLINË



**Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi**